

VENDIM
Nr. 149, datë 24.12.2013

MBI SHTYRJEN E AFATIT TË VENDIMIT NR. 54, DATË 3.5.2013,
TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s, “MBI SHTYRJEN E AFATIT TË
VENDIMIT NR. 161, DATË 7.12.2012,
TË BORDIT TË KOMISIONERËVE”

Në mbështetje të neneve 8, pika “b” dhe “ç”; 9 dhe 26 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20 dhe 21 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.12.2013, pasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike,

konstatoi se:

- Kompania “CEZ Shpërndarje” sh.a., referuar vendimit nr. 5 janar 2013, është në administrim të përkohshëm.

- “CEZ Shpërndarje” sh.a. dhe KESH sh.a nuk kanë mbyllur rakordimet për blerjet dhe shitjet e energjisë elektrike midis tyre për periudhën 2011–2012, si pamundësi kjo, për shkak të statusit juridik të “CEZ Shpërndarje” sh.a. gjatë këtij viti.

- Vendimin nr. 87, datë 29.6.2012, i Bordit të Komisionerëve të ERE-s, ka përcaktuar tarifën e furnizuesit publik me shumicë për periudhën 2012–2014, në vlerën 2.2 lekë.

- Përcaktimi i të ardhurave të tepërta për efekt të axhustimit të tarifës së transmetimit, të cilat rezultojnë nga rritja e sasisë së livruar të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes, është i kushtëzuar me tarifën e shpërndarjes.

- Përcaktimi i tarifës së shpërndarjes është i lidhur me vlerësimin më parë të komponentëve të saj, të tillë si: niveli i humbjeve dhe sasia e livruar në rrjetin e shpërndarjes, investimet e kryera.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Të lërë në fuqi deri në datën 31 dhjetor 2014, tarifat e miratuara, përkatësisht me vendimet si më poshtë:

- Vendimin nr. 144, datë 7.12.2011, “Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a., për periudhën e tretë rregullatore”;

- Vendimin nr. 87, datë 29.6.2012, “Për rishikimin e tarifës për furnizuesin publik me shumicë, për periudhën e tretë rregullatore, për akomodimin e efekteve financiare të vendimit nr. 80, datë 15.6.2012, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s”;

- Vendimin nr. 151, datë 7.12.2011, “Për përcaktimin e çmimit të shitjes të energjisë elektrike të prodhuar nga “TEC Vlorë” sh.a. te FPSH, për periudhën e tretë rregullatore”;

- Vendimin nr. 153, datë 7.12.2011, “Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga “HEC Lanabregas” sh.a. për periudhën e tretë rregullatore”;

- Vendimin nr. 146, datë 7.12.2011, të Bordit të Komisionerëve, “Për miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a., për periudhën e tretë rregullatore”;

- Vendimin nr. 147, datë 7.12.2011, “Për përcaktimin e tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike, për periudhën e tretë rregullatore, 2012–2014, dhe nr. 148, datë 7.12.2011, “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë, për periudhën e tretë rregullatore”;

- Vendimin nr. 149, datë 7.12.2011, “Për përcaktimin e çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e reja, me fuqi të instaluar deri

në 15 MW për vitin 2012”;

- Vendimi nr. 150, datë 7.12.2011, “Për përcaktimin e çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistuese, me fuqi të instaluar deri në 10 MW për vitin 2012”.

2. Përditësimin dhe kompensimin e të gjitha efekteve financiare brenda së njëjtës periudhë rregullatore, 2012–2014, apo në periudhën rregullatore pasardhëse, periudhë e cila do të shërbejë për qartësimin e gjendjes juridike të kompanisë së shpërndarjes, duke i krijuar kështu mundësinë rregullatorit për qartësimin, verifikimin dhe përcaktimin sa më të drejtë të treguesve të të ardhurave të kërkuara për aktivitetet e gjenerimit publik, furnizimit me shumicë, transmetimit, shpërndarjes së energjisë elektrike dhe furnizimit me pakicë të konsumatorët tariforë.

3. Përditësimin dhe kompensimin e të gjitha efekteve financiare brenda së njëjtës periudhë rregullatore, 2012–2014, apo për periudhën rregullatore pasardhëse, të çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet dhe ato ekzistuese, me fuqi të instaluar deri në 15 MW.

4. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë kompanitë e rregulluara për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Petrit Ahmeti